



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC
Nr. Br. No. 05-104/02-10071/26
Nr. i fq. / Br. str. / No. pg. 1-2
Data / Datum / Date 14.04.2026
OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova

Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq

Drejtoria për Planifikim Urban, Pronë dhe Kadastër

Datë/Data/Date	10/04/2026
Nga/Od/From:	Gazmend Krasniqi-Drejtor i DPUKP-së
Përmes/Preko/through	z.Halil Thaçi-Kryetar i Komunës
Për/Za/To:	z.Sami Ahmeti-Kryesues i Kuvendit Komunal
Tema/Subjekat/Subject:	Kërkesë për shfuqizimin e Vendimit të Kuvendit Komunal Nr.01-060-01-2989-26 dt.30.01.2026 për Shpalljen-Publikimin në Faqen Zyrtare të Komunës të Listës së Përgjithshme të Pronave të Paluajtshme të Komunës dhe Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që janë planifikuar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 15-99 vite për vitin vijues 2026.

I nderuar/a

Bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenin 6 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Komisioni Komunal ka përgaditur Listën e Përgjithshme të pronave të paluajtshme Komunës dhe Listën e Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që janë planifikuar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 15-99 vite për vitin vijues 2026, të cilat pastaj bazuar në kompetencat e veta ligjore Kryetari i Komunës përmes Propozim Vendimit të njejtat i ka dërguar në Kuvend për aprovim.

Me qenë se transferimi i pushtetit nga ekzekutivi kaluar në ekzekutivin aktual është bërë në një periudhë të shkurtër apo disa ditë para vitit të ri 2026, ekzekutivi i ri komunal me disa ndryshime të vogla por duke ja falur besimin ka publikuar listat të cilat kanë qenë të publikuara edhe në vitet paraprake gjë që na si ekzekutiv i ri për shkak të afateve kohore e kemi pasur të pamundur t'i bëjmë një analizë të mirëfilltë listave në fjalë.

Gjatë rrjedhës së procesit ne si ekzekutiv i ri kemi vërejtur edhe konstatuar se në kuadër të Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që janë planifikuar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 15-99 vite për vitin vijues 2026, gjenden disa prona të paluajtshme të Komunës të cilat janë në kufi me Autoudhën "Ibrahim Rugova" të cilat sipas nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-275 për Rrugët ndalohet ndërtimi i objekteve industriale.

Andaj bazuar në këtë që u cek më lartë kërkohet nga ana e juaj që në mbledhjen e radhës të Kuvendit Komunal të **SHFUQIZONI** Vendimin e Kuvendit Komunal Nr.01-060-01-2989-26 dt.30.01.2026 për Shpalljen-Publikimin në Faqen Zyrtare të Komunës të Listës së Përgjithshme të Pronave të Paluajtshme të Komunës dhe Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që janë planifikuar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 15-99 vite për vitin vijues 2026.

Me respekt!

